

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	10 ditët që ndryshuan rrjedhën e inteligjencës artificiale
ADRESA	https://www.koha.net/tech/10-ditet-qe-ndryshuan-rrjedhen-e-inteligjences-artificiale
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	21 shtator 2026, 02:18:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:34:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8f9c4ee80e5112dd05e72289024d9bc43b5f89f7d01d80f3fa7eba137d1b76f8
TEKSTI	a421b3abddd850253b7923fc94b82b9e64ec362ffd43cada6e61ed25873c081c
PAMJA	1ef2239b7bbc5c0a8e73aab20af2d72abe067ad5fb1de491503ce622c8d0c4fa

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dc692993b11f7e679407307ffd4219e7f5a4bc098a150df889fa50e0f4b89a05
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	eac8701d2d51767a98591a9049587e8e6bdc5b672839ca848ac021bfff05a4aef
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/dc692993b11f7e679407307ffd4219e7f5a4bc098a150df889fa50e0f4b89a05

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

TECH

10 ditët që ndryshuan rrjedhën e inteligjencës artificiale



Foto: Associated Press

20 shtator 2026 17:34

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalën tonë zyrtar në Viber

Brenda vetëm dhjetë ditësh, gara për ndërtimin e sistemeve gjithnjë e më të fuqishme të inteligjencës artificiale u shndërrua nga një betejë për dominim teknologjik në një debat të fortë mbi kontrollin, sigurinë dhe rrezikun ekzistencial që mund të sjellë AI.

Zhvillimet e fundit kanë bërë që vetë kompanitë që po ndërtojnë sistemet më të avancuara të inteligjencës artificiale të përballen me një pyetje shumë më të madhe: çfarë ndodh nëse këto sisteme bëhen më të fuqishme sesa aftësia e njerëzve për t'i kontrolluar ato?

Alarmi u ngrit pas një serie zhvillimesh që përfshinë dorëheqje të studiuesve, paralajmërime për rrezikun e zhdukjes së njerëzimit dhe raportime se agjentë të inteligjencës artificiale kishin arritur të anashkalonin mekanizmat mbrojtës dhe të ndërhyjnë në sisteme kompjuterike, raportoi Reuters.

Një prej studiuesve të Anthropic, Joe Benton, u largua nga kompania duke paralajmëruar se ritmi aktual i zhvillimit të AI-së mund të përbëjë kërcënim ekzistencial, ndërsa studiuesi Evan Hubinger deklaroi publikisht se ekziston mundësia që inteligjenca artificiale të shkaktojë zhdukjen e njerëzimit.

Në qendër të shqetësimeve është ideja se sistemet e ardhshme të AI-së mund të jenë në gjendje të përmirësojnë vetveten dhe të ndërtojnë versione gjithnjë e më të avancuara pa ndërhyrje të drejtpërdrejtë njerëzore. Ky vizion lidhet me konceptin e inteligjencës së përgjithshme artificiale (AGI), sistem hipotetik që do të ishte në gjendje të kryente një gamë shumë të gjerë detyrash në nivele të krahasueshme ose më të larta se njerëzit.

Edhe



Tech • 12 sht 2026

Eksperti i inteligjencës artificiale bën thirrje për ngadalësim të zhvillimit

Showbiz.

Werner Herzog parashikon gjëra të mëdha për Orlando Bloom

Lifestyle.

Cilat simptoma sëmundjesh nuk duhet t'i injoroni?

Showbiz.

Gwyneth Paltrow tregon për vështirësitë pas ndarjes me Chris Martin

Futboll.

Parisi fiton derbin ndaj Marseillet

Futboll.

Fitore bindëse e Milanit

Botë.

Merz e quan "katastrofë" rezultatit e CDU-së, por premtan se do të qëndrojë në detyrë

Disa studiues kanë argumentuar se AGI-ja mund të shtaqet shumë më shpejt nga sa ishte parashikuar më parë, madje brenda disa viteve. Kjo ka nxitur shqetësim jo vetëm në komunitetin shkencor, por edhe në mesin e politikanëve dhe drejtuesve të kompanive më të mëdha teknologjike.

Një moment kyç ndodhi më 3 shtator, kur OpenAI prezantoi modelin e saj të ri, Astra. Presidenti i kompanisë, Greg Brockman, e përshkroi momentin si hyrjen në “epokën e AGI-së”.

Por në të njëjtën kohë, kompania pranoi se, derisa modelet bëhen më të afta, bëhet gjithnjë e më e vështirë të kuptohet saktësisht se çfarë janë në gjendje të bëjnë.

Shqetësimi nuk lidhet vetëm me aftësinë e këtyre sistemeve për të prodhuar tekst, imazhe apo kod.

OpenAI ka raportuar më herët se disa agjentë të saj kishin dalë jashtë një mjedisi të kontrolluar testimi dhe kanë sulmuar sistemet e platformës Hugging Face. Sipas raportimeve, raste të tjera të ngjashme u zbuluan edhe në javët pasuese.

Këto zhvillime kanë shtuar frikën se ritmi i zhvillimit mund të jetë duke tejkaluar aftësinë e kompanive për të testuar dhe kuptuar plotësisht modelet e reja përpara se ato të publikohen.

Më 8 shtator, studiuesi i Anthropic, Jacob Coxon, njoftoi largimin e tij nga kompania. Në një seri postimesh publike, ai shprehu shqetësimin se laboratorët e AI-së po marrin rrezikë që mund të kenë pasoja për të gjithë shoqërinë.

Dorëheqja e tij mori vëmendje të madhe dhe u bë pjesë e një debati më të gjerë brenda industrisë.

Joe Benton, një tjetër studiues i larguar nga Anthropic, argumentoi se kompanitë nuk mund të mbikëqyrin në mënyrë efektive sistemet në shkallën me të cilën po trajtohen.

Sipas tij, nëse zhvillimi vazhdon me të njëjtin ritëm, problemet mund të shfaqen më shpejt sesa koha që u nevojitet studiuesve për t'i identifikuar dhe korrigjuar ato.

Më 12 shtator, drejtuesi i Anthropic, Dario Amodei, bëri thirrje për ngadalësimin e zhvillimit të AI-së.

Amodei paralajmëroi se ritmi i rritjes së aftësive të modeleve mund të çojë brenda një periudhe relativisht të shkurtër në sisteme me aftësi shumë më të mëdha për të vepruar në internet.

Edhe



Tech • 17 sht 2026

Microsoft: AI mund të krijojë “specie” të re që konkurron me njerëzit

Thirrjes iu bashkuan drejtues të disa prej kompanive kryesore të sektorit, përfshirë Sam Altman të OpenAI, Demis Hassabis të Google DeepMind dhe Elon Musk të xAI. Ata mbështetën, ndër të tjera, idenë që kompani të jashtme të kenë qasje në sistemet e AI-së për të ndihmuar në vlerësimin e sigurisë së tyre.

Një bashkëpunim i tillë është i pazakontë në një industri ku kompanitë konkurrojnë ashpër për të zhvilluar dhe publikuar modelet më të avancuara.

Drejtori ekzekutiv i Nvidias, Jensen Huang, ka kundërshtuar idenë e pezullimit të zhvillimit të AI, duke argumentuar se sistemet gjithnjë e më të fuqishme janë të rëndësishme për avancimin e teknologjisë.

Edhe Meta ka mbajtur një qëndrim tjetër. Mark Zuckerberg ka argumentuar se laboratorët duhet të përcaktojnë vetë ritmin e zhvillimit dhe se kompanitë kanë stimuj të fortë për të parandaluar dëmet që mund të shkaktojnë modelet e tyre.

Ndërkohë, shefi i AI-së në Microsoft, Mustafa Suleyman, ka paralajmëruar për vështirësinë e kontrollimit të sistemeve që afrohen me atë që përshkruhet si superinteligjencë.

Debati për sigurinë zhvillohet në një kohë kur interesat ekonomike të industrisë janë jashtëzakonisht të mëdha.

OpenAI dhe Anthropic po përgatiten për raunde të reja financimi dhe, sipas raportimeve, vlerësimet e tyre të tregut mund të arrijnë nivele rekord. OpenAI po shqyrton një financim që mund ta çojë vlerësimin e kompanisë në rreth 1.5 trilionë dollarë.

Kina, ndërkohë, ka propozuar një qasje më të strukturuar për sigurinë e AI-së, përmes detyrimeve për zhvilluesit, standardeve të mbështetura nga shteti, vlerësimeve të sigurisë dhe testeve të jashtme.

Ajo që ka ndryshuar gjatë këtyre dhjetë ditëve nuk është vetëm debati mbi një teknologji të re. Është vetë mënyra se si industria po diskuton për të ardhmen e saj.

Përkrahësit e zhvillimit të shpejtë e shohin AI-në si një nga teknologjitë më transformuese në histori, me potencial për të rritur produktivitetin, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve shkencore dhe mjekësore dhe për të ndryshuar industri të tëra.

Kritikët dhe studiuesit e sigurisë, ndërkaj, paralajmërojnë se aftësitë e këtyre sistemeve po rriten më shpejt sesa mekanizmat për t'i kuptuar dhe kontrolluar ato.

Edhe

Botë

• 17 sht 2026

Mbreti Charles III thotë se AI-ja mund të paraqesë rrezik nëse bie në duar të gabuara

Tani, pyetja është nëse industria do të arrijë të vendosë kufij të rinj përpara se aftësitë e sistemeve të saj të bëhen shumë të vështira për t'u kontrolluar.

Dhjetë ditët e fundit kanë treguar se gara për AI-në nuk është më vetëm një garë për modelin më të fuqishëm. Ajo është bërë një betejë për të përcaktuar se sa shpejt duhet të ecë kjo teknologji dhe sa kontroll duhet të ruajë njeriu mbi të.

#INTELIGJENCA ARTIFICIALE

#TEKNOLOGJI

Artikuj të ngjashëm

Botë

• 16 sht 2026

Trumpi minimizon rrezikun nga AI-ja, por rrit shqetësimet

Botë

• 14 sht 2026

Kina kritikon idenë se është përfshirë në “konkurrencë keqdashëse” lidhur me AI-në

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzimet për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

+383 (0) 38 249 105 /

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.